

VENDIM
Nr. 803, datë 12.12.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 441, DATË 3.6.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E HARTIMIT TË PROJEKTEVE PËR
MIRATIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT PËR NDËRTIMIN E NJËSIVE TË
BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË ZONAT E SHPALLURA PËR ZHVILLIM
TË DETYRUAR, NË BASHKITË DURRËS, KAVAJË, KAMZË, MIRDITË, KRUIJË,
KURBIN, LEZHË, SHIJAK DHE VORË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 441, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shifra dhe fjalët “... 254 159 368 (dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH” zëvendësohen me “...165 743 507 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e shtatëqind e dyzet e tre mijë e pesëqind e shtatë) lekë pa TVSH ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku